



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria -Vlada-Government*

**Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural**  
**Ministarstvo Poljoprivrede, Sumarstva i Ruralnog Razvoja**  
**Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development**

Në mbështetje të nenit 145 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 1.3 pika (d) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 të datës 13 shtator 2001 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë dhe neni 12 paragrafi 2 pika 16, neni 14, 18 paragrafi 1, neni 22 pika 2 Ligji Nr.2003/5 i Kosovës për farërat, dt. 15 prill 2003,

Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,  
Nxjerr sa vijon:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV NR.01/2009**  
**Për paketimin dhe etiketimin e farës së certifikuar**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Me këtë udhëzim administrativ përcaktohen kriteret e paketimit dhe etiketimit e farës që përdoren për shumëzim dhe tregtim e që janë të paketuara dhe etiketuara sipas skemës së Organizata Ekonomike për Kooperim dhe Zhvillim - OECD.

**Neni 2**  
**Paketimi i Farës**

1. Fara e certifikuar e të gjitha kategorive dhe perzierjet e farës, duhet të shitën në paketime të mbyllura dhe të padëmtuara.
2. Këtij udhëzimi administrativ nuk i nënshtrohen paketimet e vogla të farës - farërat që përdoren për marketing.

**Neni 3**  
**Fara e certifikuar për të gjitha kategorit përveq paketimeve të vogla**

1. Paketimet e farës së certifikuar, duhet të jenë të mbyllura:
  - 1.1 Jo më vonë se në kohën e mostrimit;
  - 1.2 Nën mbikqyrejen e zyrtarve nga MBPZHR;
  - 1.3 Në atë mënyrë që paketimet nuk mund të hapen pa dëmtimin e sistemit të mbylljes dhe etiketës zyrtare.

**Neni 4**  
**Përzirjet e farërave**

Për farërat e përziera vlejné kriteret e njëjta siç janë të përcaktuara në nenin 3 të këtij udhëzimi administrativ përveq që mostrimi i farës nuk bëhet në momentin e mbylljes.

**Neni 5**  
**Fara e krjuesit dhe paketimet e vogla**

Paketimet e Farës së krjuesit dhe paketimet e vogla, duhet të mbyllën në atë mënyrë që nuk mund të hapen pa dëmtimin e sistemit të mbylljes.

**Neni 6**  
**Ripaketimet**

Kriteret për ripaketim janë të njëta si në rastin e paketimit të përcaktuara në nenin 3 të këtij udhëzimi administrativ, përveq që fara nuk duhet patjetër të mostrohet.

**Neni 7**  
**Përrjashtëm**

Këtij udhëzimi administrativ nuk i nështrohen farërat e pa paketuara - refus që shkojnë drejtpërdrejt te fermeri.

**Neni 8**  
**Mbyllja e paketimeve**

Mbyllja e paketimeve dhe ripaketimet, duhet bërë nën mbikqyrjen e personave të autorizuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural .

**Neni 9**  
**Etiketimi i Paketimeve**

1. Fara e cila importohet nga vendet tjera, duhet të jenë të etiketuar në bazë të skemës së OECD.
2. Fara e cila tregtohet, duhet të jetë e etiketuar siç është e përshkruar në këtë udhëzim administrativ, përveq në rastet kur:
  - 1.1 Fara është e prodhuar për përpunim;
  - 1.2 Fara e cila i shitët drejtpërdrejt fermerit.

**Neni 10**  
**Fara e krijuesit dhe paketimet e vogla**

Fara e krjuesit dhe paketimet e vogla mund të shiten me etiketë të prodhuesit.

**Neni 11**  
**Fara e certifikuar**

1. Fara e certifikuar PB, BS, CS, C1, C2 dhe përzirjet e farës të prodhuara, përpunuara, të paketuara dhe të mbyllura në Kosovë, duhet të jenë të etiketura me një etiketë e cila është shtypur nga organi kompetent i MBPZHR-së.
2. Etiketimi i paketimeve, duhet të bëhet gjatë procesit të mbylljes së paketimeve të farës.
3. Fara e cila ripaketohet, duhet të ri etiketohet nën mbikqyrjen e personave të autorizuar të MBPZHR-së.

## **Neni 12**

### **Dokumentacion brenda paketimeve**

1. Për farën BS, CS, C1 dhe C2, farërat e përzira përveq paketimeve të vogla duhet që brenda paketimeve të kenë dokumentacion plotësues, në të cilën shkruhet numri i referencës, lloji dhe varieteti.
2. Dokumentacioni brenda kontinjerit nuk është i nevojshëm në rastet kur:
  - 1.1 Numri referues i kontigjentit të farës, lloji dhe varieteti janë të shënuara dhe janë pa shlyeshme në mbështjellsin e paketimit;
  - 1.2 Kur etiketa zyrtare ose etiketa e OECD është rezistente ndaj shkoputjes.

## **Neni 13**

### **Etiketimi i paketimeve të mëdha**

Farërat BS, CS, C1 dhe C2 të cilat paktohen në kontinjer të mëdhenj, duhet të jenë të etiketuara.

## **Neni 14**

### **Etiketimi i Farës së Modifikuar Gjenetikut**

Çdo farë e modifikuar gjenetikut, duhet të identifikohet si në etiketë ashtu edhe në dokumentacionet tjera përcjellëse e cila aplikohet për të gjitha kategoritë e farës.

## **Neni 15**

### **Etiketimi i farës së trajtuar**

1. Nëse fara e krjesit, Parabazike, Bazike, Farë e Certifikuar, C1, C2, ose fara e përzier janë të trajtuara, në etiketën zyrtare, duhet të shënohet emri i preparatit i cili është përdorur për trajtim.
2. Informatat, duhet të jenë të shënuara në pjesën e jashtme të paketimit, duke përfshirë edhe shënimet brenda në paketim përveq në rastet kur informatat për trajtimin me preparate kimike janë dhënë në etiketën rezistente ndaj shkoputjes ose është vetë ngjithëse.
3. Në rastet kur fara shitet drejtpërdrejt tek fermeri këto informata duhet të përcillen me dokumentacion përcjellëse të farës.

## **Neni 16**

### **Rietiketimi**

Nëse paketimet e farës së certifikuar PB, BC, CS, C1, C2 përveq paketimeve të vogla ripaketohen këtë veprim, duhet cekur në etiketën zyrtare së bashku me datën e ripaketimit dhe autoritetin përgjegjës për ripaketim.

## **Neni 17**

### **Etiketimi i paketimeve të vogla**

Për paketime të vogla si të farës CS, C1, C2 informatat për farën, duhet të jenë të paraqitura në paketim.

## **Neni 18**

### **Ngjyra e etiketes**

1. Varësisht nga kategoria e farës, ngjyra e etiketës, duhet të jetë:

- 1.1 Fara parabazë PB e bardhë me vijë diagonale ngjyrë vjollce;
- 1.2 Fara Bazë BS e bardhë;
- 1.3 Fara Certifikuar CS e kaltër;
- 1.4 Fara e Certifikuar e gjeneratës së parë C1 e kaltër;
- 1.5 Fara e Certifikuar e gjeneratës së dytë C2 e kuqe;
- 1.6 Përzirjet - foragjere e gjelbër.

### **Neni 19** **Përmbajtja e etiketës zyrtare**

1. Të dhënat e shënuara në etiketën zyrtare duhet të jenë të shkruara me shkronja dhe emra latin për llojin dhe varietetin, si në vijim:
  - 1.1 Autoriteti certifikues;
  - 1.2 Numri i referencës për sasinë;
  - 1.3 Lloji;
  - 1.4 Varieteti i vijës natyrore të misrit ose vijës natyrore të lulediellit;
  - 1.5 Kategoria;
  - 1.6 Vendi i prodhimit;
  - 1.7 Muaji dhe viti i mbylljes;
  - 1.8 Trajtimi i farës;
  - 1.9 Peshë e paraqitur neto ose bruto ose numri i farërave;
  - 1.10 Farërat e modifikuar gjenetikiisht, duhet të cekën në etiketë.
2. Madhësia e etiketës, duhet të jetë 110 mm x 67 mm.

### **Neni 20**

Moszbatimi i këtij Udhëzimi Administrativ, sanksionohet sipas nenit 24 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 2003/5 Kosovës për farëra.

### **Neni 21** **Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 02.02.2009

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural  
Ministri,  
Idriz Vehapi

---